Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues	9.1	Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Ofruesit të Shërbimeve 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme: (a) Ofruesi i Shërbimeve dështon në përmbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitojë ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të shërbimeve; (b) Ofruesi i Shërbimeve refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhrave administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;
Ndërprerja nga ana e Ofruesit të Shërbimeve	10.1	Ofruesi i Shërbimeve, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues; a. nuk arrin t'i paguajë Ofruesit të Shërbimeve shumat që duhet të paguhen në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit;
Obligimet e Ofruesit të Shërbimeve	11.1	Ofruesi i Shërbimeve do të kryej Shërbimet sipas kontratës me kujdes, efikasitet dhe zell, në përputhje me praktikat më të mira profesionale. 11.2 Ofruesi i Shërbimeve duhet të veprojë sipas urdhrave administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Ofruesi i Shërbimeve konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi. 11.3 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.
Obligimet e Autoritetit kontraktues	12.1	Autoriteti kontraktues do t'i ofrojë ofruesit të shërbimeve menjëherë ndonjë informacion dhe/ose dokumentacion në dispozicion të tij, që mund të jenë relevante për zbatimin e kontratës.

		Dokumente të tilla do t'i kthehen Autoritetit Kontraktues në fund të periudhës së zbatimit të detyrave. 12.2 Autoriteti Kontraktues do të bashkëpunoj sa më shumë që është e mundur me Ofruesin e Shërbimeve për t'i siguruar informacione që ky i fundit mund t'i kërkoj në mënyrë të arsyeshme për kryerjen e kontratës. 12.3 Autoriteti Kontraktues do të caktoj “Menaxherin e Projektit”, me vendim, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së shërbimeve gjatë gjithë kohës dhe për raportimin e çdo hollësie Autoritetit Kontraktues	
Dëmet likuiduara	e	13.1	Ofruesi i Shërbimeve do të paguaj dëmet e likuiduara Autoritetit Kontraktues në normën ditore 0.25% për çdo ditë që Data e Përfundimit është me vonë se Data e Kërkuar e Përfundimit. Shuma totale e dëmeve të likuiduara nuk duhet të tejkaloj shumën e përcaktuar në KVK. Autoriteti Kontraktues mund të zbres dëmet e likuiduara nga pagesat për shkak të Ofruesit të Shërbimeve. Pagesa e dëmeve të likuiduara nuk do të ndikoj në detyrimet e Ofruesit të Shërbimeve. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për tërë kontratën është <u>[10% të Kontratës]</u> të çmimit final të kontratës.
Siguria ekzekutimit	e	14	14.1 Ofruesi i Shërbimeve do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mire të kontratës. Shuma e sigurisë është 10% e vlerës së kontratës. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosëkzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Ofruesit të Shërbimeve. 14.2 Garancioni do të vazhdojë të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të Çertifikatës së Përfundimit. 14.3 Garanconi i ekzekutimit të kontratës do të jetë në formatin e dhënë në Pjesën IV të kësaj kontrate
Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimeve	i	15.1	Rreziqet dhe mbulimi nga sigurimi do të jenë: Ofruesi i Shërbimeve do të marr dhe do të ruaj, dhe do të shkaktoj Nënkontraktorët të marrin dhe ruajnë, me shpenzimet e tyre, por në bazë të kushteve të miratuara nga Autoriteti Kontraktues, sigurimin nga rreziqet, dhe për mbulim, për çdo mospermbushje të kontrates sigurimi i ekzekutimit do të konfiskohet
Parimet përgjithshme të pagesës	e	16	16.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Pagesat që duhet të bëhen sipas faturës së lëshuar nga Ofruesi i Shërbimeve do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, Identifikimi Financiar, i kësaj kontrate që e plotëson Ofruesi i Shërbimeve
Kontrolli kualitetit	i	17.1	Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues. Autoriteti kontraktues do të kontrollojë punën e ofruesit të shërbimeve dhe të njoftojë atë për çdo defekt që është gjetur. Kontrolli i tillë nuk do të ndikojë në përgjegjësitë e ofruesit të shërbimeve. Autoriteti Kontraktues mund të udhëzojë ofruesit e shërbimeve të kërkojnë një defekt dhe të zbulojnë dhe provojnë çdo shërbim që Autoriteti Kontraktues konsideron se mund të ketë një defekt. Periudha garantuese e defekteve është +30 ditë nga përfundimi i kontratës
Konsekuencat e Shkeljes së kontratës	e	19.1	Konsekuencat e Shkeljes së kontratës 19.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë siç është cekur në Nenin 9 dhe 10. 19.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime: a) dëmet; dhe/ose

		b) ndërprerjen e kontratës. 19.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë: a) Dëme të përgjithshme; ose b) Dëme të likuidueshme. 19.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	Me marreveshje
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	21.1	<i>[shëno te dyja]</i> Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatës Themelore në Prishtinë, - Departamenti për Çështje Ekonomike

PËRMBAJTJA E PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL

Hyrja

1. Pjesa e hyrjes së PZHK-së përfshin, por nuk kufizohet me:
 - 1.1. listën e kontribuesve, si stafi komunal, konsulentët dhe të tjerët, të cilët kanë kontribuar në hartimin e PZHK-së;
 - 1.2. prezantimi i përmbajtjes, që përfshin:
 - 1.2.1. tabelën e përmbajtjes;
 - 1.2.2. listën e akronimeve dhe shkurtesave;
 - 1.2.3. listën e tabelave;
 - 1.2.4. listën e grafikëve;
 - 1.2.5. listën e hartave;
 - 1.2.6. listën e fotografive; dhe
 - 1.2.7. listën e referencave;
 - 1.3. informata për vendimet e Kuvendit të Komunës në lidhje me PZHK-në:
 - 1.3.1. vendimi i Kuvendit të Komunës për hartimin e PZHK-së në përputhje me Nenin 10, paragrafin 2.1 të Ligjit; dhe
 - 1.3.2. vendimi i Kuvendit të Komunës për miratimin dhe zbatimin e PZHK-së në përputhje me Nenin 10, paragrafin 2.2 të Ligjit.
 - 1.4. informata për miratimet:
 - 1.4.1. vendimi për pëlqimin mjedisor për Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM) të PZHK-së;
 - 1.4.2. vendimi i miratimit për PZHK-në në përputhje me Nenin 9, paragrafin 2.3.1 të Ligjit, dhe
 - 1.4.3. pëlqime të tjera përkatëse nëse janë të nevojshme;
 - 1.5. informata për kornizën strategjike të marrë parasysh gjatë hartimit të PZHK-së, përfshirë:
 - 1.5.1. strategjitë sektoriale afatshkurta, afatmesme dhe afatgjata në nivel lokal dhe qendror;
 - 1.5.2. strategjitë prej planeve të mëparshme komunale;
 - 1.5.3. strategjitë rajonale ose strategjitë e komunave fqinje; dhe
 - 1.5.4. udhëzimet, përgjegjësitë dhe kërkesat që burojnë nga konteksti i gjerë i planifikimit siç janë planifikuar në - Planin Hapësinor të Kosovës dhe Hartën Zonale të Kosovës.
 - 1.6. informata për procesin e planifikimit:
 - 1.6.1. përshkrimi dhe listimi i prezantimeve publike, konsultimeve, takimeve rishikuese dhe mekanizmave të përdorur për të angazhuar publikun në procesin e planifikimit; dhe
 - 1.6.2. të dhënat e marra nga qytetarët dhe mënyra e trajtimit të tyre gjatë procesit të planifikimit.
 - 1.7. pjesa e hyrjes së PZHK-së gjithashtu përfshinë një përmbledhje jo- teknike të PZHK-së, për të përshkruar një përmbyllje të shkurtër të PZHK-së, fokusuar në temat thelbësore komunale, sfidat përkatëse dhe mundësitë për zhvillim, si dhe qëllimet dhe objektivat e planifikimit të zhvillimit.

Profili komunal

1. Profili komunal shqyrton dhe përmbledh të dhënat lidhur me:
 - 1.1. historinë e zhvillimit;
 - 1.2. gjendjen ekzistuese të komunës; dhe
 - 1.3. kapacitetet njerëzore dhe financiare të komunës.
2. Mbledhja e të dhënave për Profilin Komunal bëhet në pajtueshmëri me Shtojcën 1 të këtij Udhëzimi Administrativ.

Vlerësimi i gjendjes

1. Vlerësimi i gjendjes shqyrton dhe vlerëson të dhënat e Profilin Komunal për t'i paraqitur trendet, nevojat, projeksionet dhe prognozat dhe supozimet e ardhshme që janë relevante për komunën. Për shembull, fushat kyçe për analizë mund të përfshijnë projeksionet e popullsisë, prognozat e gjendjes ekonomike, nevojat për banim në të ardhmen, si dhe lëvizjen e njerëzve, mallrave dhe shërbimeve përgjatë rrugëve specifike të komunikimit.
2. Vlerësimi i gjendjes shqyrton dhe vlerëson përparësitë, dobësitë, mundësitë dhe rreziqet për komunën që përkufizojnë nevojat dhe kërkesat e fushave zhvillimore sektoriale.
3. Vlerësimi i gjendjes përfshin shqyrtimin e fushave tematike specifike relevante për komunën, si dhe me komunat fqinje, nivelin qendror dhe normat teknike të planifikimit hapësinor.
4. Vlerësimi i gjendjes përqëndrohet në identifikimin e sfidave të lidhura me fushat tematike me vëmendje të posaçme lidhur me implikimet e tyre hapësinore.
5. Vlerësimi i gjendjes rezulton në gjetje kyçe, dhe supozime të pranuar për:
 - 5.1. konstatime gjeografike dhe mjedisore;
 - 5.2. trendët dhe prognozat demografike;
 - 5.3. gjendjen e secilës fushë sektoriale dhe nevojave përkatëse, kërkesave dhe mundësive për zhvillim;
 - 5.4. identifikimin e implikimeve hapësinore për komunën; dhe
 - 5.5. identifikimin e nevojave që duhen adresuar, dhe plotësuar në mënyrë që të tejkalohen sfidat kryesore të zhvillimit hapësinor.

6. Këtu gjetje kyçe, përfundime koncize dhe supozime të pranuar duhet të përdoren për të krijuar bazën për hartimin e Kornizës së Zhvillimit Hapësinor dhe Prioriteteve të Zhvillimit Strategjik.
7. Të dhënat për fushat tematike dhe trendet e prezantuara në vlerësimin e gjendjes merren parasysh në të gjitha pjesët tjera të PZHK-së.
8. Fushat tematike përfshijnë por nuk kufizohen në:
 - 8.1 **Ekonomike.** Kjo pjesë shqyrton dhe vlerëson gjendjen ekzistuese të ekonomisë komunale. Kjo pjesë përfshin por nuk kufizohet në:
 - 8.1.1. një përmbledhje dhe vlerësim të ekonomisë lokale si ekonomitë familjare, punësimi dhe papunësia, sektorët ekonomik dhe struktura e tyre dhe, bizneset përfshirë ekonominë bujqësore nëse është relevante për komunën;
 - 8.1.2. lidhja e veprimtarive ekonomike me komunat fqinje dhe nëse është relevante me shtetet fqinje;
 - 8.1.3. një përmbledhje dhe vlerësim të gjendjes ekzistuese të resurseve dhe shërbimeve turistike siç janë hapësirat për akomodim dhe shërbim të ushqimit;
 - 8.1.4. vlerësim të zonave ekonomike egzistuese dhe të planifikuara dhe ndikimi i tyre; dhe
 - 8.1.5. një përmbledhje të përparësive dhe dobësive të ekonomisë lokale.
 - 8.2. **Infrastruktura teknike.** Kjo pjesë shqyrton dhe vlerëson gjendjen ekzistuese të instalimeve nëntokësore dhe mbitokësore të energjisë termike, rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit, ujitjes, drenazhimit, telekomunikacionit dhe infrastrukturës për grumbullimin dhe menaxhimin e mbeturinave në komunë. Kjo pjesë përfshin por nuk kufizohet në:
 - 8.2.1. një inventar të infrastrukturës ekzistuese teknike me rëndësi të nivelit lokal dhe qendror, duke paraqitur shtrirjen, lokacionet dhe kapacitetet e kësaj infrastrukture;
 - 8.2.2. një vlerësim të nevojave në të ardhmen për një infrastrukturë të tillë;
 - 8.2.3. kapacitetet e nevojshme të infrastrukturës së zgjeruar apo të re; dhe
 - 8.2.4. vlerësim të kapacitetit financiar dhe teknik të Komunës që të realizoj kapacitetet e nevojshme të infrastrukturës teknike.
 - 8.3. **Infrastruktura e transportit dhe transporti.** Kjo pjesë shqyrton dhe vlerëson gjendjen ekzistuese të rrugëve dhe brezëve mbrotjës rrugor si dhe infrastrukturën transportuese në komunë. Kjo pjesë përfshin por nuk kufizohet në:
 - 8.3.1. shtrirjen dhe gjendjen e rrugëve ekzistuese;
 - 8.3.2. shtrirja dhe kategoria e rrugëve të planifikuara nga niveli qendror;
 - 8.3.3. vlerësimin e intensitetit dhe kapacitetit të kryqëzimeve dhe korsive kryesore;
 - 8.3.4. modelet e qarkullimit të trafikut;
 - 8.3.5. linjat transportuese ndërkomunale e brenda komunës urbane dhe rurale;
 - 8.3.6. shfrytëzimi i rrugëve nga makinat, këmbësorët, biçikletat dhe metodat tjera të transportit;
 - 8.3.7. vlerësimi i hapësirave ekzistuese për parkim;
 - 8.3.8. vlerësim të nevojave në të ardhmen për një infrastrukturë transportuese; dh
 - 8.3.9. vlerësim të kapacitetit financiar dhe teknik të Komunës që të realizoj infrastrukturën e nevojshme të transportit;
 - 8.4. **Infrastruktura publike dhe sociale.** Kjo pjesë shqyrton dhe vlerëson gjendjen ekzistuese të infrastrukturës publike dhe sociale me rëndësi lokale dhe qendrore. Kjo pjesë përfshin por nuk kufizohet në:
 - 8.4.1. një inventar të ndërtimeve dhe hapësirave për veprimtari publike ekzistuese siç janë ato mjekësore, arsimore, postës, të administratës publike dhe shërbimeve të tjera të ngjashme;
 - 8.4.2. një inventar të ndërtimeve dhe hapësirave ekzistuese për veprimtari sociale siç janë ato kulturore, sportive, peshkimit, gjuetisë, bibliotekave, për komunitetin, parqeve publike, varrezave dhe shërbimeve të ngjashme;
 - 8.4.3. një vlerësim të nevojave për hapësira dhe ndërtime në të ardhmen për të gjitha shërbimet publike dhe sociale; dhe
 - 8.4.4. vlerësim të kapacitetit financiar dhe teknik të mund të realizoj të gjitha ndërtimet dhe hapësirat e nevojshme për shërbimet publike dhe sociale;
 - 8.5. **Mjedisi dhe sipërfaqet me rrezikshmëri.** Kjo pjesë shqyrton dhe vlerëson gjendjen ekzistuese të mjedisit në komunë, duke evidentuar ndotjet, shtrirjen hapësinore të ndotjeve dhe degradimeve, dhe masat e nevojshme të parandalimit dhe mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore etj. Kjo pjesë përfshin, por nuk kufizohet në:
 - 8.5.1. ndotjen e ajrit;
 - 8.5.2. ndotjen e ujit;
 - 8.5.3. ndotjen e tokës;
 - 8.5.4. ndotjen nga zhurma;
 - 8.5.5. përmblytjet;
 - 8.5.6. erozionin dhe sedimentimin;
 - 8.5.7. rrëshqitjet e tokës;
 - 8.5.8. ortekët dhe shpatet e pjerrëta;

- 8.5.9. tërmetet;
 - 8.5.10. sipërfaqet me ndotje të lartë;
 - 8.5.11. sipërfaqet e rrezikuara nga zjarri; dhe
 - 8.5.12. masat e nevojshme të parandalimit dhe mbrojtjes që të jenë në përputhje me Vlerësimin Strategjik Mjedisor;
- 8.6. **Asetet e trashëgimisë natyrore, kulturore dhe turistike.** Kjo pjesë shqyrton dhe vlerëson gjendjen ekzistuese të pasurive natyrore, kulturore dhe turistike të komunës dhe nëse mbrojtja, ruajtja dhe aktivitetet zhvillimore ekzistuese dhe ato të propozuara të pasurive natyrore, kulturore dhe turistike, i plotësojnë kërkesat ligjore të komunës. Kjo pjesë përfshin, por nuk kufizohet në:
- 8.6.1. rezervat strikte;
 - 8.6.2. monumentet natyrore;
 - 8.6.3. peizazhet natyrore;
 - 8.6.4. trashëgiminë arkitekturale;
 - 8.6.5. trashëgiminë arkeologjike;
 - 8.6.6. trashëgiminë shpirtërore;
 - 8.6.7. trashëgiminë e luajtshme; dhe
 - 8.6.8. peizazhet kulturore;
- 8.6.9. kjo pjesë identifikon dhe vlerëson ndikimin hapësinor dhe mundësitë e zhvillimit të krijuara nga parqet kombëtare, sipërfaqet e mbrojtura, zonat e mbrojtura dhe zonat e veçanta të mbrojtura brenda territorit të komunës.
- 8.7. **Vendbanimet.** Kjo pjesë shqyrton dhe vlerëson gjendjen ekzistuese dhe shtrirjen hapësinore të të gjitha vendbanimeve sipas klasifikimit të më poshtëm:
- 8.7.1.1. karakterit urban/ rural;
 - 8.7.1.2. madhësisë dhe numrit të banorëve
 - 8.7.1.3. funksionalitetit dhe rrjetit ndërlidhës; dhe
 - 8.7.1.4. llojit dhe lartësisë mbidetare.
- 8.7.1. Kjo pjesë po ashtu identifikon dhe i vlerëson të gjitha ndërtimet pa leje dhe vendbanimet joformale; dhe
- 8.7.2. analizon raportin në mes sipërfaqeve të ndërtuara dhe të pa ndërtuara në kuadër të vendbanimeve.
- 8.8. **Banimi.** Kjo pjesë shqyrton dhe vlerëson gjendjen ekzistuese të banimit dhe modeleve të banimit në komunë dhe nevojat në të ardhmen. Kjo pjesë përfshin, por nuk kufizohet në :
- 8.8.1. një inventar dhe analizë të nevojave për banim që identifikojnë numrin e njësive të banimit të nevojshme për popullsinë sipas rritjes së parashikuar;
 - 8.8.2. një analizë të kushteve të banimit, përfshirë rekomandimet për zhvillimin e banimit dhe për përmirësimin e kushteve të banimit;
 - 8.8.3. një analizë të ndërtesave të banim të zbrazëta, përfshirë dhe mundësitë për ri-përdorimin e tyre;
 - 8.8.4. trendët e ndërtimit të ndërtesave për banim dhe çmimet mesatare të ndërtesave për banim; dhe
 - 8.8.5. identifikimin e tokës së mjaftueshme për banim, përfshirë banimin për familjet me të ardhura të ulëta, të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara.
- 8.9. **Vendbanimet Joformale.** Kjo pjesë shqyrton dhe vlerëson gjendjen ekzistuese, shtrirjen hapësinore, karakteristikat, numrin e banorëve, gjendjen ekonomike, sociale dhe mjedisore të vendbanimeve joformale të identifikuara;
- 8.9.1. Kjo pjesë shqyrton dhe analizon mundësitë e integritetit dhe trajtimit të vendbanimeve joformale të identifikuara brenda territorit të Komunës.
- 8.10. **Shfrytëzimi i tokës.** Kjo pjesë shqyrton dhe vlerëson gjendjen ekzistuese të shfrytëzimeve si dhe modelet e shfrytëzimit të tokës brenda territorit të komunës.
- 8.10.1. Kjo pjesë gjithashtu vlerëson projeksionet për shfrytëzimin e tokës në PZHK-të e mëparshme dhe deri në çfarë mase këto projeksionet janë realizuar.

Korniza e Zhvillimit Hapësinor

1. Korniza e Zhvillimit Hapësinor prezanton procesin e përgjithshëm strategjik dhe qasjen, duke e përshkruar të ardhmen e dëshiruar dhe duke nënvizuar se çfarë duhet të arrihet në mënyrë që të sjellë zhvillim dhe përmirësim të mirëqenies së qytetarëve.
2. Korniza e Zhvillimit Hapësinor të jetë ndërvepruese, e ndërthurur dhe gjithëpërfshirëse për të siguruar që strategjitë zbatohen duke i përdorur objektivat më të përshtatshme e të realizueshme dhe që objektivat e ndryshme tematike nuk bien në kundërshtim me njëra tjetrën.
3. Korniza e Zhvillimit Hapësinor përbëhet nga komponentët në vijim:
 - 3.1. Vizionin;
 - 3.2. Qëllimet;
 - 3.3. Objektivat; dhe
 - 3.4. Koncepti i Zhvillimit Hapësinor.

4. Korniza e Zhvillimit Hapësinor përfshin të gjitha temat thelbësore, që burojnë nga pjesa e Profilit të Komunës dhe Vlerësimit të Gjendjes, nëpërmjet të cilave strukturohen analizat hapësinore dhe të konceptohen propozimet hapësinore.
5. Vizioni:
 - 5.1. Vizioni përshkruan konceptin e gjerë të vizionit të komunës për të ardhmen;
 - 5.2. Vizioni përmban një apo më shumë deklarata tematike, të cilat konceptojnë në kushte të përgjithshme zhvillimin e qëllimeve dhe objektivave që synohen të arrihen në të ardhmen në komunë; dhe
 - 5.3. Deklarata e vizionit mund të paraqitet edhe nëpërmjet hartave konceptuale hapësinore.
6. Qëllimet:
 - 6.1. Qëllimet prezantojnë deklarata të përgjithshme të drejtimeve të planifikuara zhvillimore në komunë, për ta arritur vizionin; dhe
 - 6.2. Qëllimet të jenë të përgjithshme, afatgjate dhe të kenë disa objektiva.
7. Objektivat:
 - 7.1. Objektivat janë deklarata që përshkruajnë një gjendje specifike të ardhshme që do të arrihet në periudhën e deklaruar kohore për të arritur një qëllim; dhe
 - 7.2. Objektivat të jenë specifike, të matshme, të arritshme, relevante dhe të propozohen për të arritur një periudhë kohore specifike.
8. Vizioni, Qëllimet dhe Objektivat definojnë në bashkëpunim të ngushtë me komunitetin dhe palët e interesit.
9. Koncepti i Zhvillimit Hapësinor:
 - 9.1. Koncepti i Zhvillimit Hapësinor cakton logjikën hapësinore dhe integrimin e kërkesave të planifikimit hapësinor që rrjedhin prej vizionit, qëllimeve dhe objektivave përmes tërësive të zgjidhjeve të propozuara të planifikuara nëpërmjet përshkrimit tekstual dhe hartave konceptuale hapësinore për të gjitha strategjitë sektoriale dhe propozimet për zhvillim për komunën duke adresuar:
 - 9.1.1. mbrojtjen e mjedisit, trashëgimisë natyrore dhe kulturore;
 - 9.1.2. zhvillimin ekonomik të propozuar;
 - 9.1.3. infrastrukturën teknike;
 - 9.1.4. infrastrukturën publike dhe sociale;
 - 9.1.5. vendbanimet, banimi i planifikuar dhe trajtimi i vendbanimeve joformale;
 - 9.1.6. shfrytëzimi i planifikuar i tokës siç janë, bujqësi, banim, komerciale, teknologjike, industriale dhe shfrytëzim i përzier; dhe
 - 9.1.7. propozimet për zgjerim si dhe ndryshime nga PZHK-ja e mëparshme;
 - 9.2. Koncepti i Zhvillimit Hapësinor merr parasysh dhe reflekton gjendjen aktuale dhe zhvillimet e planifikuara.
 - 9.3. Koncepti i Zhvillimit Hapësinor të jetë i strukturuar mirë dhe të përmbajë të dhëna të mjaftueshme që të mund të kuptohet si i vetëm.
 - 9.4. Koncepti i Zhvillimit Hapësinor jep bazën e zhvillimit dhe të shfrytëzimit të tokës gjatë procesit të vendim marrjes dhe hartimit të kushteve zhvillimore të Hartës Zonale të Komunës;
 - 9.5. Koncepti i Zhvillimit Hapësinor përdorë konceptet vijuese për të arritur qëllimet dhe objektivat hapësinore:
 - 9.5.1. Nyeje: hapësira që mbështesin dhe promovojnë intensitetet të lartë të shfrytëzimit të tokës dhe aktiviteteve;
 - 9.5.2. Korridore: lidhjet ndërmjet nyjeve, përgjatë të cilëve, natyrshëm mund të joshet dhe inkurajohet një intensitet i rritur i zhvillimit.
 - 9.5.3. Plotësimi dhe dendësimi: hapësira të cilat mbushen dhe dendësohen me zhvillime të caktuara, mënyrë kjo për të arritur integrimin hapësinor dhe për të rritur kufijtë e popullsisë;
 - 9.5.4. Mbajtja nën kontroll: ky koncept i referohet nevojës për të kufizuar zhvillimin joefikas me dendësi të ultë, në mënyrë tipike përmes përdorimit të një skaji urban i cili tregon kufirin për zhvillim urban për një periudhë të përkufizuar kohore;
 - 9.5.5. Mbrojtja: ky koncept shprehimisht ka për qëllim mbrojtjen e resurseve të vlefshme natyrore, kulturore, ekonomike dhe të trashëgimisë; dhe
 - 9.5.6. Zonat e rritjes: i referohet ri-zhvillimit të zonave të zhvilluara ekzistuese në intensitetet më të larta dhe zhvillimit të tokës së zbrazët të përshtatshme për plotësim për të siguruar shfrytëzim efektiv të tokës.
10. Skenarët e Propozuar Hapësinor:
 - 10.1. Koncepti i Zhvillimit Hapësinor prezantohet përmes skenarëve të propozuar hapësinor që paraqesin përshkrime tekstuale dhe harta që përshkruajnë zgjerimet, kërkesat për shfrytëzimin e tokës në të ardhmen, masat mbrojtëse dhe zonat që do të mbrohen, si dhe ndryshimet e propozuara dhe zhvillimet e reja;
 - 10.2. skenarët e propozuar hapësinor shpallen në shqyrtim publik; dhe

10.3. skenari i propozuar hapësinor, i cili zhvillohet tutje për të plotësuar të gjitha kërkesat e këtij Udhëzimi Administrativ, zgjidhet në bashkëpunim të ngushtë me komunitetin dhe palët e interesit.

11. Koncepti i Zhvillimit Hapësinor përmes hartës për shfrytëzimin e planifikuar të tokës dhe hartave për planet zhvillimore sektoriale krijon bazën për Prioritetet e Zhvillimit Strategjik dhe Planin të Veprimit.

Prioritetet e Zhvillimit Strategjik dhe Planin të Veprimit

1. Kjo pjesë analizon nevojat e identifikuara nëpërmjet vlerësimit të gjendjes dhe harton zgjidhje në formën e Prioriteteve Zhvillimore Strategjike në përputhje me Vizionin, Qëllimet dhe Objektivat.
2. Prioritetet e Zhvillimit Strategjik po ashtu caktojnë edhe aktivitetet për zbatimin e planeve zhvillimore sektoriale
3. Analiza e të gjitha prioriteve strategjike dhe zgjidhjeve të propozuara do të merr parasysh:
 - 3.1. resurset e nevojshme financiare, njerëzore dhe hapësinore për arritjen e objektivave dhe planeve;
 - 3.2. efektiviteti dhe afati kohor; dhe
 - 3.3. analiza e përfitimeve nga shpenzimi (kost-benefiti) në të cilën krahasohen shpenzimet e përafërta me përfitimet publike dhe sociale që lidhen me projektet ose vendimet e veçanta.
4. Të gjitha Prioritetet e Zhvillimit Strategjik u shtohen të dhënat e mëposhtme:
 - 4.1. aktivitetet në formën e një plani ose projekti;
 - 4.2. dobitë publike dhe sociale që rezultojnë nga projekti;
 - 4.3. afatin kohor; dhe
 - 4.4. vlerësimin e kapaciteteve ekzistuese financuese për zbatimin e projektit dhe burimet shtesë të financimit dhe mekanizmat, nëse nevojiten.
5. Prioritetet e Zhvillimit Strategjik zhvillohen në bashkëpunim me udhëheqjen komunale dhe harmonizohen me strategjitë ekzistuese sektoriale para hartimit të Planit të Veprimit.
6. Planin të Veprimit të paraqesë një përmbledhje të hollësishme të të gjitha projekteve dhe masave, veprimeve të nevojshme për të arritur Objektivat dhe Prioritetet e Zhvillimit Strategjik.
7. Planin të Veprimit për secilin projekt, masë dhe veprim specifikon si më poshtë:
 - 7.1. përshkrim i projektit, masës dhe aktivitetit;
 - 7.2. prioriteti i zbatimit (i lartë, i mesëm, ose i ultë);
 - 7.3. afati kohor i zbatimit (afatshkurtër, afatmesëm ose afatgjatë);
 - 7.4. implikimet financiare (minimale, të vogla, të mesme dhe të mëdha);
 - 7.5. aranzhimet për zbatim, siç janë partneritetet publiko-private, etj;
 - 7.6. zotimet paraprake për tu siguruar që financat dhe resurset e tjera do të dorëzohen kur të jenë të nevojshme dhe sipas planit;
 - 7.7. resurset e tjera të nevojshme (njerëzore, teknike dhe të tjera) të nevojshme për zbatimin e aktivitetit;
 - 7.8. një buxhet i përafërt dhe kategoria e buxhetit për shpenzimet;
 - 7.9. financime buxhetore shtesë nëse është e nevojshme;
 - 7.10. roli dhe përgjegjësitë për secilën organizatë përgjegjëse, partnerin implementues ose hisedar;
 - 7.11. çfarëdo marrëveshje zbatimi ndërmjet komunës dhe organizatave të tjera qeveritare ose të tjera;
 - 7.12. treguesit përkatës; dhe
 - 7.13. procesi i monitorimit dhe vlerësimit.

Paraqitja hartografike

1. Pjesa Hartografike e PZHK së përbëhet nga hartat e integruara sipas fushave tematike për tërë hapësirën e komunës të përgatitur në sistemin zyrtar të planifikimit hapësinor në një platformë GIS, i cili paraqet informacione thelbësore për të gjitha planet zhvillimore sektoriale si rrjedhojë e Konceptit të Zhvillimit Hapësinor dhe Prioriteteve Strategjike të Zhvillimit. Këto harta përfshijnë por nuk kufizohen vetëm në të mëposhtmet:
 - 1.1. Harta e zhvillimit hapësinor të planifikuar paraqet të gjitha vendbanimet ekzistuese dhe të planifikuara më hapësirat për ndërtim dhe masat e mbrojtjes për zhvillim;
 - 1.2. Harta e shfrytëzimit të planifikuar të tokës përcakton shfrytëzimin e ardhshëm të tokës për bujqësi, banim, komerciale, teknologjike, industriale dhe shfrytëzim i përzier;

1.3. Hartat e planeve zhvillimore sektoriale përfshirë hapësirat, ndërtimet dhe infrastrukturën e planifikuar me të gjitha instalimet mbitokësore dhe nëntokësore, si më poshtë:

- 1.3.1. Harta e Planit të Zhvillimit Ekonomik;
- 1.3.2. Harta e Planit të Infrastrukturës së Transportit;
- 1.3.3. Harta e Planit të Transportit urban dhe rural;
- 1.3.4. Harta e Planit të Energjisë Elektrike dhe Termike
- 1.3.5. Harta e Planit të Ujësjetës dhe Kanalizimit;
- 1.3.6. Harta e Sistemit të Ujitjes dhe të drenazhimit;
- 1.3.7. Harta e Planit të Telekomunikacionit dhe Instalimeve të Ngjajshme;
- 1.3.8. Harta e Planit të Hapësirave Publike dhe Sociale;
- 1.3.9. Harta e Planit të Hapësirave Sportive;
- 1.3.10. Harta e Planit të Hapësirave të Hapura Publike dhe të Gjelbra;
- 1.3.11. Harta e Planit të Menaxhimit të Varrezave; dhe
- 1.3.12. Harta e Planit për Mbrojtjen e Trashëgimisë Natyrore dhe Kulturore.
- 1.3.13. Harta e Planit për Mbrojtjen nga Rreziqet Natyrore; dhe
- 1.3.14. Harta e Planit për Menaxhimin e Mbeturinave dhe Riciklim.

ZBATIMI DHE MONITORIMI

Dispozitat për zbatim dhe monitorim

1. Dispozitat për Zbatim udhëheqin arritjen e qëllimeve dhe objektivave të Planit Zhvillimor Komunal.
2. Anulimi apo shtyrja e zbatimi të ndonjë aktiviteti të Planit të Veprimit të PZHK-së bëhet vetëm me pëlqimin paraprak të Kuvendit të Komunës.
3. Nëse bëhet një vendim për shtyrjen apo anulimin e një aktiviteti, Plani i Veprimit do të përditësohet me vendimin e ri.
4. Monitorimi i PZHK-së bëhet njëkohësisht me zbatimin e PZHK-së.
5. Dispozitat për Zbatim përmbajnë një mekanizëm për monitorimin dhe vlerësimin e progresit të komunës drejt arritjes së të gjitha aspekteve të planit, në bazë të treguesve të matshëm.
6. Monitorimi i Zbatimit të PZHK-së bëhet sipas procesit të monitorimit dhe vlerësimit i përcaktuar në Planin e Veprimit nëpërmjet informatave të mëposhtme:
 - 6.1. burimi/ burimet e të dhënave;
 - 6.2. frekuenca e mbledhjes së të dhënave;
 - 6.3. të dhënat bazë;
 - 6.4. qëllimet dhe kornizat kohore për arritjen e qëllimeve;
 - 6.5. institucioni/ institucionet përgjegjës për mbledhjen e të dhënave; dhe
 - 6.6. sistemi i përdorur për menaxhim të të dhënave.
7. Raportet prezantohen në Raportin vjetor monitorues të zbatimit të qëllimeve dhe objektivave të deklaruara në Planin Zhvillimor Komunal sipas nenin 10, paragrafi 3 nga Ligji.

Autoritetet për Zbatim dhe Monitorim

1. Kuvendi i Komunës është përgjegjës për alokimin e fondeve për zbatimin e PZHK-së.
2. Autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor, bashkërendon aktivitetet e zbatimit dhe monitorimit të PZHK-së.
3. Drejtoritë komunale sektoriale zbatojnë dhe monitorojnë aktivitetet sektoriale përkatëse të tyre sipas Procesit të monitorimit dhe vlerësimit në Planin e Veprimit.
4. Drejtoritë sektoriale hartojnë dhe dorëzojnë raportet sektoriale vjetore për zbatimin dhe monitorimin e PZHK-së tek autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor.
5. Autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor harton dhe dorëzon raportin vjetor ndërsektorial për zbatimin dhe monitorimin e PZHK-së, për miratim tek Kuvendi i Komunës.
6. Autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor, dorëzon raportin e miratuar vjetor ndërsektorial për zbatimin dhe monitorimin e PZHK-së në Ministri.
7. Autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor siguron se raporti i miratuar vjetor ndërsektorial për zbatimin dhe monitorimin e PZHK-së publikohet në faqen e internetit të komunës dhe ofrohet në kopje të letrës sipas kërkesës.

Komuna e Obiliqit

NR.	AKTIVITETET	DETYRAT			
2	1. Hartimi i Koncept Planit	A. Hartimi i Kornizës Logjike të PZHK-së B. Hartimi i Reziqeve/Kërcënimeve			
	2. Përpilimi i Formatit për ndërtimin e Profilit për Drejtoritë relevante Sektoriale	A. Analiza e Ligjeve relevante B. Përpilimi i Verzionit të parë të Formatit E. Konsultimi me KD dhe GP G. Finalizimi i Draftit - Inkorporimi i komenteve dhe sygjërimeve			
		3. Hartimi i Planit të Punës	A. Hartimi i Planit të Punës		
		Projekt Plani			
		Koncepti dhe projektplani I rishikuar Moduli për mbledhjen e të dhënave			
	3	1. Analiza e Grupeve të Interesit	A. Hartimi i Listës së Grupeve të Interesit B. Hartimi i skemës organizative		
2. Punëtori me Grupet e Interesit		A. Zhvillimi i Metodologjisë B. Përpilimi i Përmbledhjes së Aktivitetit, Agjendës, Listës së pjesmarrësve, etj C. Takime koordinimi me Grupet e Interesit D. Përgatitja e Prezenteve E. Organizimi i Punëtorisë F. Raporti I Punëtorisë			
		Punëtorja me Grupet e interesit			
		Raporti i punëtorisë			
		4	1. Mbledhja e të Dhënave brenda Drejtorive Komunale	A. D.Administratës së Përgjithshme B. D. Arsimit C. D. Ekonomi dhe Financa D. D. për Urbanizëm, Planifikim,Pronë dhe Kadastër E. D. Ambientit F. D. Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale G. D. Shërbimeve Publike dhe Emergjencë H. D. Për Kultur, Rini dhe Sport I. D. Inspektoratit J. D. Për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural K. D	
				2. Mbledhja e të Dhënave nga Niveli Qendror (	A. Përpilimi I Listës së Burimeve të Informatave

	dhe Kompanitë Regjionale)	B. Takime koordinimi me Nivelin Qendror dhe Kompanitë Regjionale
		C. Mbledhja e të Dhenave
		D. Vlerësimi i të Dhënave
	3. Vlerësimi i të Dhënave	A. Vlerësimi i të dhënave të mbledhura
	B. Identifikimi i mangësive në databazën e krijuar	
	D. Takime koordinimi me Grupin Kryesor	
Takimet për koordinim me nivelin qendror (dhe regjional)		
Të dhënat e mbledhura		
5	1. Përpilimi i Sfondit	A.PZH - fushëveprimi
		B.Plani hapësinor i Kosovës
		C.Korniza Ligjore
		D.Përmbledhje e Vlerësimit të PZH/PZHU
	2. Përpilimi i Profilit Komunal	A. Përpilimi i Profilit për Sektorët
		B. Futja e të dhënave në rrjetin e GIS-it
		C. Përpilimi i Hartave
		D. Vlerësimi i Nevojave
	3. Konsultimi i Profilit Komunal nga Grupet Punuese	B. SWOT Analiza e gjendjes ekzistuese
		A. Konsultimi nga Grupet Punuese
	4. Prezentimi publik i Profilit komunal	B. Inkorporimi i komenteve dhe sygjërimeve
		A.Zhvillo Metodologjinë
		B. Pregaditje logjistike
		C. Përpilimi i prezantimeve
		D. Ditët e prezentimit
		E. Raporti i Prezantimeve
Aprovimi i draftit të profilit komunal nga EKP (Ekipi Komunal i Planifikimit)		
6	1. Punëtorja e Vizionimit	A. Punët përgaditore
		B. Ditët e Punëtorisë
		C. Raporti i Punëtorisë
	2. Vizioni, Qëllimet dhe Objektivat	A. Përcaktimi i Vizionit
		C. Definimi i qëllimeve/objektivave
Punëtorja e Vizionimit		
Raporti i Punëtorisë Drafti i vizionit, qëllimeve dhe objektivave		
7	1. Analiza Hapësinore dhe përcaktimi i Prioriteteve Strategjike	A. Vlerësimi/Hartimi i Kërkesave Minimale Hapësinore për sektorët relevant/Koncepti zhvillimor
		B. Përcaktimi i prioriteteve strategjike
		C. Konsultimi me GP
		D. Finalizimi i kapitullit
	2. Konsultimi përfundimtar i draft dokumentit nga Grupet Punuese (GP)	A. Konsultimi nga GP
		B. Inkorporimi i komenteve dhe sygjërimeve

Aprovimi i Draftit të PZHK-së nga KD		
Përpilimi i Kërkesave Hapësinore dhe Prioriteteve Strategjike		
8	1. Konsolidimi i Dokumentit	A. Konsolidimi i dokumentit
		B. Inkorporimi i komenteve dhe sygjërimeve
	2. Shqyrtimi Publik	C. Prezentimi Publik në Zonën Urbane dhe Rurale
		D. Raporti i Shqyrtimit Publik
		E. Inkorporimi i komenteve dhe sygjërimeve
	3. Dorëzimi në MMPH	B. Inkorporimi i komenteve dhe sygjërimeve
	4. Raporti Përmbyllës i projektit	A. Përpilimi i Raportit Përmbyllës të projektit
Aprovimi i PZHK-së		
Drafti final i PZHK-së		
Raporti i Shqyrtimit Publik		
Raporti përmbyllës i Projektit		

1. Kohëzgjatja

Plani sipas përshkrimeve duhet të përfundoj mbrenda periudhës 7 (shtatë) mujore.

Programi i punës për hartimin dhe menaxhimin e Planit Zhvillimor Komunal

Për shkak të kërkesave të reja ligjore dhe mungesës së kapaciteteve njerëzore për të përgatitur Planin Zhvillimor Komunal (PZhK), Komuna do të angazhojë një kompani konsulente që mbështes Komunën në hartimin e këtij dokumenti shumë të rëndësishëm për zhvillimin e Komunës.

Detyrat	Aktivitetet	Qëllimi	Kohëzgjatja	Përgjegjës
1. Përcaktimi i grupit punues	A. Përcaktimi i udhëheqësit komunal të projektit, koordinatorëve të drejtorive (KD) vijuese: a. Administratë e Përgjithshme b. Bujqësi dhe Zhvillim Rural c. Kulturë, Rini dhe Sport d. Mbrojtje dhe Mjedis e. Punët Inspektuese f. Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale g. Arsimit h. Ekonomi, Financa dhe Zhvillim i. Urbanizëm, Planifikim, Kadastër dhe Pronë j. Infrastrukturë rrugore k. Shërbime Publike dhe Emergjencë	Në mënyrë që PZhK të përgatitet, nevojiten të përcaktohen personat përgjegjës të cilët do të mbikëqyrin këtë proces dhe përmbajtjen që i përket drejtorive sektoriale	5 ditë	Kryetari i Komunës
2. Përcaktimi i grupeve të interesit	A. Përcaktimi i grupeve lokale të interesit, institucioneve të qeverisë qendrore, organizata të jashtme që ofrojnë shërbime publike, OJQ, biznese, përfaqësues të fshatrave dhe bashkësive lokale (GP); B. Krijimi i listës dhe kontakteve të pjesëmarrësve.	Në mënyrë që PZhK të përkrahet nga banorët e Komunës, nevojitet që të përcaktohet organizatat dhe përfaqësuesit e komuniteteve.	5 ditë	Udhëheqësi komunal i projektit
